



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI.
Sesioni Pranveror

Komisioni për Integrime Evropiane
Mbledhja nr. 15.
Prishtinë, më 28.03.2018 në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRIME EVROPIANE

Në mbledhje morën pjesë: Blerta Deliu- Kodra, Zenun Pajaziti, Armend Zemaj, Ilir Deda, Ahmet Isufi, Milaim Zeka, Fikrim Damka, Fitore Pacolli dhe Fatmire Kollçaku.

Munguan: Adem Hoxha dhe Glauk Konjufca.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Ahtere Loxha, Adelina Demolli, Safet Beqiri dhe Florent Mehmeti.

Te ftuar: znj. Dhurata Hoxha, ministre e Integritimit Evropian.

Pjesëmarrësit të tjerë: Përfaqësuesi nga GIZ, OSBE-së, NDI, KDI, Zyra e BE-së dhe mediat.

Mbledhjen e kryesoi Blerta Deliu- Kodra, kryetare e Komisionit.

Kryetarja, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë e hapi mbledhjen e Komisionit me këtë:

Rend Dite

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 06.03.2018;
3. Raportim i znj. Dhurata Hoxha, ministre e Integritimit Evropian, lidhur me procesin e liberalizimit të vizave;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-031 për Pajisjet nën Presion, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;

6. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-036 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për të Huajt, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
7. **Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-026 për Azil, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së;**
8. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i Rendit te ditës

Kryetarja njoftoi se ministri i Drejtësisë, z. Abelard Tahiri, për shkak të një obligimi, kishte kërkuar mirëkuptim nga anëtarët që të vijë të raportojë para Komisionit pas dy orëve, pyeti anëtarët se a pajtohen për këtë ndryshim dhe të vazhdohet me pikat e tjera.

Kryetarja konstaton se Rendi i ditës u miratua me ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 06.03.2018

Procesverbali, i mbledhjes së mbajtur më 06.03.2018, u miratua pa vërejtje.

3. Raportim i znj. Dhurata Hoxha, ministre e Integritimit Evropian, lidhur me procesin e liberalizimit të vizave

Kryetarja i uroi mirëseardhje ministres dhe tha se duke pasur parasysh se Kuvendi i Kosovës ka ratifikuar demarkimin ndërmjet Kosovës dhe Malit të Zi, ju kemi ftuar lidhur me përmbushjen e kriterit të dytë që është luftimi i korrupsionit dhe krimi të organizuar, lidhur me këtë kriter a është kërkuar nga BE-ja që të ndërmerret ndonjë masë legjislative dhe po ashtu se cilat veprime i keni ndërmarrë si ministre e Integritimit Evropian lidhur me këtë çështje.

Dhurata Hoxha, ministre e Integritimit Evropian theksoi se në qershor të vitit 2012, Kosova pranoi udhërrëfyesin për liberalizimin e vizave i cili ka përmbajtur 95 kritere që duhet përmbushur.

Që nga ajo kohë, institucionet e Kosovës kanë qenë subjekt i vlerësimit më rigoroz që është aplikua ndonjëherë nga BE-ja në kuadër të liberalizimit të vizave.

Me anë të një pune intensive ne kemi arritur të bindim institucionet e BE-së që Kosova ka kapacitet të zbatojë obligimet e saja në kuadër të procesit të integritimit Evropian.

Deri më sot, në kuadër të procesit të liberalizimit të vizave, Komisioni Evropian ka bërë 4 vlerësime të përmbushjes së prioritetëve që dalin nga udhërrëfyesi për liberalizimin e vizave. Respektivisht, në shkurt 2013, korrik 2014, dhjetor 2015 dhe maj 2016.

Raporti i fundit i muajit maj 2016 ka vlerësuar se janë përmbushur të gjitha kriteret dhe Komisioni Evropian do të bëjë propozimin për plotësim ndryshimin e Rregullores 539/2001 për liberalizim të vizave me Kosovën. Raporti njëkohësisht ka nënvizuar se deri në ditën e miratimit të propozimit për plotësim ndryshimin e Rregullores 539/2001, Kosova do të ratifikojë marrëveshjen e demarkacionit me Malin e Zi dhe do të bëjë progres në luftimin e krimi të organizuar dhe korrupsionit.

Në këtë kontekst, më 21 mars 2018 Kuvendi plotësoi edhe kriterin kyç të mbetur – ratifikimin e demarkacionit me Malin e Zi.

Në kuadër të vizitës së Presidentit Juncker, më 28 shkurt 2018, institucionet e Kosovës kanë bërë dorëzimin e raportit për përmbushjen e kriterit të dytë, respektivisht vazhdimin e luftës kundër krimi të organizuar dhe korrupsionit.

Në kuadër të Ekipit të Përbashkët për Luftimin e Krimeve Serioze, respektivisht udhëheqjen e Prokurorisë Speciale: Janë shenjëzuar 39 raste; janë ngritur 30 aktakuza; 23 raste janë në shkallët e ndryshme të shqyrtimit gjyqësor; 7 raste janë përmbyllur në formë të vendimit të prerë.

Vlerësimi i jonë është që për qëllime të liberalizimit të vizave, kriteri i luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar është i përmbushur. Natyrisht, jemi të vetëdijshëm që lufta kundër kësaj dukurie duhet intensifikuar edhe më shumë, pasi që progresi në këtë fushë është fillimisht në interes të qytetareve tonë, dhe më pastaj të Bashkimit Evropian. Më lejoni t' ju informoj për hapat e ardhshëm në kuadër procesit të vendim-marrjes së institucioneve të BE-së!

Synimi ynë është që gjatë këtij viti të përfundojnë të gjitha procedurat e nevojshme institucionale të BE-së për të siguruar plotësim ndryshimin e Rregullores 539/2001 të Bashkimit Evropian. Ky synim nënkupton hapat si vijon; Fillimi i negociatave për plotësim ndryshim Rregullores 539/2001 në mes 3 institucioneve kryesore të BE-së: Komisioni Evropian, Këshilli i BE-së dhe Parlamenti Evropian!

Miratimi i Rregullores në seancën plenare të Parlamentit Evropian; Miratimi i Rregullores nga Këshilli i Ministrave; Ceremonia e nënshkrimit; Publikimi në gazetën zyrtare; dhe hyrja në fuqi.

Ne presim që e gjithë procedura e cekur të mos marrë më shumë se 6 muaj, gjithmonë duke u bazuar në rastet e mëparshme të procedurave të liberalizimit të vizave. Mirëpo, duhet nënvizuar që tani institucionet e Kosovës kanë përfunduar detyrat e veta dhe përgjegjësia është në anën e institucioneve të BE-së për të marrë hapa institucional në afat sa më të shkurtër kohor.

Sa i përket votimeve teknike votimi në Këshill do të jetë bazuar në shumicë e dyfishtë, apo me fjalë tjera duhet të votojnë 16 vende anëtare që përfaqësojnë të paktën 65% të popullsisë së BE-së. Ndërsa në seancën plenare të Parlamentit Evropian, votimi do të bëhet me shumicë të thjeshtë në leximin e parë dhe në lexim të dytë me shumicë absolute. Gjithashtu dua të nënvizojë se ende na presin shumë punë dhe procedurat ende vazhdojnë të parapara nga institucionet përkatëse.

Kryetarja pyeti ministren, sa kemi arritur që në përqindje të kryejmë obligimin tonë karshi luftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit sepse po e konsideroj se kushtin tjetër e kemi të përmbyllur bazuar në përvojat e shteteve të tjera të cilat kanë kaluar në të njëjtin proces, ku jemi ne, si Kosovë, kur do ta marrim rekomandimin pozitiv nga komisioni dhe sa pritni si ministre që do të jetë e komplikuar faza e procedurave dhe votimit, sepse ka shumë shtete anëtare me të cilat ne kemi nevojë që të fuqizojmë jo vetëm diplomacinë parlamentare, por edhe kontaktet e Qeverisë dhe të gjithë mekanizmave institucional, sepse siç e thatë votimi merr bukur përgjegjësi nga shtetet anëtare dhe shtetet që e kundërshtojnë Republikën e Kosovës dhe natyrisht do ta kenë presionin e tyre lidhur me fazën e fundit të votimit. A presim që ne në fund të viti të lëvizim lirshëm.

Fitore Pacolli theksoi se sot po flasim për fillimin e lobimit dhe bashkëpunimin me shtetet të cilat duhet ta bëjnë edhe votimin për liberalizimin e vizave, pra nuk paska qenë kushti i vetëm dhe i fundit demarkacionit, e dimë se kërkesë kryesore, sa i përket kushtit të luftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit është të krijohet një regjistër i hetimeve, andaj na tregoni a është krijuar ky regjistër dhe nëse janë vetëm këto raste të prezantuara, nuk janë të mjaftueshme, a është krijuar regjistri i kërkuar për vendimet në

formë të prerë të gjykatave, pastaj kërkohet regjistri i konfiskimeve në lidhje me rastet e krimit të organizuar dhe korrupsionit në nivelin e lartë .

Ne, po ashtu, në komision jemi marrë vesh që raporte të tilla të mos pranojmë në Komision dhe ky raport prej dy faqesh nuk përmban asgjë të re dhe vetëm informatat e dhëna nëpër media.

Në vazhdim tha se dua ta ngritë një çështje, ju si ministre i përgjigjeni Kuvendit dhe jeni të detyruar të na jepni informatat e nevojshme që ne ta kryejmë punën tonë. Më 17 mars kam kërkuar nga shefi i kabinetit tuaj që të jap informata rreth raportit të cilët e kanë dorëzuar 3 ekspertët e BE-së .

Ju keni ironizuar duke mos dhënë as përgjigje me shkrim me emalin zyrtar të cilin e kam dërguar, ju në këtë mënyrë ministre nuk e keni pohuar as mohuar ekzistimin e raportit. Ky raport ekziston dhe 3 ekspertët evropianë kanë vlerësuar punën në sistemin e drejtësisë së Kosovës, në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit i cili qartë thotë se sistemi i drejtësisë ka dështuar në luftimin e kësaj dukurie dhe ka mungesë të madhe në harmonizimin e ligjeve me legjislacionin e BE-së.

Shqetësimi mbetet te pavarësia e gjyqësorit dhe autonomia e prokurorëve, veçanërisht kur merren me rastet e hetimit të krimeve në nivelin e lartë, pra del se ka pasur hetime vetëm në nivelin e ultë të detyrës, e jo kokat e krimit që janë të identifikuar. Ju na deklaroni se e keni përmbushur kriterin, kurse në raport i cili ka dalë para dy javëve thuhet se nuk është bërë asnjë hap që duhet bërë në përmbushjen e këtij kriteri.

Vërejtje të tjera ka pasur edhe në masat e përgjimit që janë përdorur pa ndonjë strategji hetimi dhe mungon koordinimi i plotë mes prokurorisë dhe policisë, pra këto janë vetëm disa nga vërejtjet që i kam konsideruar të rëndësishme dhe që do të merren parasysh. Ky raport është mbajtur i fshehur dhe nuk i është treguar opinionit edhe pse kemi kërkuar. Atëherë a mund të na tregoni se sa ky raport ndikon në përgjigjen finale të BE-së për liberalizimin e vizave dhe a mund të pranoni para qytetarëve se çështja e demarkacionit ishte vetëm sa t' ju hidhni hi syve qytetarëve, vetëm sa ta mbulonit kushtin e dytë thelbësor me të cilin ne jemi duke çaluar.

Ministrja tha se është e vështirë që në përqindje të dimë se sa është përmbushur kriteri pasi që është kriter që duhet të monitorohet dhe të prodhohet rezultat, kurse sa i përket procedurave dhe çka presim nga shtetet që mund ta pengojnë këtë proces, mund të them se përkundër faktit që 5 vendet nuk na kanë njohur, 4 prej tyre kanë qenë shumë pragmatike në qasjen e tyre ndaj përkrahjes së Kosovës në procesin e integritimit evropian në përgjithësi dhe posaçërisht në procesin e liberalizimit të vizave, por vetëm nga Spanja mund të presim rezistencë për shkak të ndryshimit të rrethanave atje. Tani procedurat janë në duart e BE-së dhe duke u bazuar në shtetet që kanë kaluar në këto procedura ne presim që brenda 6 muajve kosovarët të udhëtojnë pa viza.

Sa i përket lobimit, ajo tha se lobimi është një proces në vazhdimësi nuk është proces që ndalet pas liberalizimit të vizave dhe është proces që e bëjnë të gjitha shtetet.

Lidhur me regjistrin, tha se është i krijuar, dhe vetë data baza e 39 rasteve është regjistër që shënon të gjitha veprimet që janë ndërmarrë me këto 39 raste, kurse sa i përket raportit që u përmend ato janë të rregullta dhe nuk lidhen vetëm me liberalizimin e vizave, e analizojnë në mënyrë të rregullt sektorin e sundimit të ligjit dhe gjithnjë kemi pas raporte të tilla.

Kurse sa i përket pyetjes se a do të ndikojë në vendimin final lobimi dhe a do të përfundohen procedurat, ju si anëtare e Komisionit znj. Pacolli duhet t'i dini procedurat. Ne, si ministri, i dimë se cilat janë procedurat e vendimmarrjes në BE dhe ato janë që ju shpjegova më herët, pra një vendimmarrje në mes të 3 institucioneve: Komisionit, Këshillit të ministrave të Parlamentit Evropian dhe sipas afateve të paracaktuara të

takimeve që atje do të mbahen, ne presim që shumë shpejt të fillojë procesi i vendimmarrjes dhe shqyrtimi i raportit që ne e kemi dërguar si institucione të Kosovës.

Fitore Pacolli tha se nuk kërkova të na i përsëritni procedurat sepse ne i dimë shumë ma mirë, por ju duhet të na tregoni hapat të cilat i keni ndërmarrë si ministri, dhe sa i përket raportit thoni se ato janë të rregullta dhe nuk është raport i liberalizimit të vizave, raporti paraqet gjendjen reale dhe vendimet kur i marrin shtetet evropiane a nuk ju besojnë ekspertëve të vet që i kanë dërguar?

Armend Zemaj tha se pavarësisht që ne dëshirojmë të shohim rezultate konkrete dhe rruga drejt BE-së të shkurtohet, mirëpo tani besoj se të gjithë duhet të jemi koshientë për gjendjen reale në vend, por prej këtij pozicioni mendoj duhet të jemi real në atë që e pasqyrojmë, sepse edhe po të dëshirojmë që ne të kemi pasqyrë tjetër matja bëhet në bazë të rezultateve konkrete, pjesa e demarkimit përfundoj dhe është shkurtuar rruga për liberalizimin e vizave dhe tani na duhet biseduar dhe ta kemi një agjendë strikte rreth ndjekjes së hapave që ta përmbushim këtë vullnet politik të mbetur edhe të pjesës evropiane, por mbi të gjitha si hap konkret i institucioneve tona ne luftimin e dukurive negative në vend, ne tani jemi vonë si i institucioneve sidomos me ligjet kyçe që janë dhe me ndryshimet legislative për përmbushjen edhe të angazhimeve sipas agjendës evropiane të reformave.

Te pjesa tjetër që dëgjuam që një ndër kushtet për luftimin e krimit dhe korrupsionit përpos Track rekord janë edhe ndryshimet legislative si Kodi penal dhe Kodi i procedurës penale, Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale apo edhe Ligji për konfiskimin e pasurisë, ju si ekip qeveritar duhet të na tregoni se cilat janë hapat dhe angazhimi konkret në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Ju e përmendet pjesën që ndër lidhet me prokurorin speciale, mendoj se kjo pjesë duhet të jetë e ndarë, sepse politika nuk mundet me e ndjek krimin e organizuar dhe korrupsionin, por duhet të krijoj kushte dhe ligje dhe duhet të gjejmë një mundësi të llogaridhënies sepse nëse e lejojmë të pjesa e gjyqësorit, e kemi pa deri më tani si shkon. Problemi tjetër që ministria duhet ta ketë parasysh është largimi i EULEX-it, bartja e lëndëve tash sidomos të krimit të organizuar dhe korrupsionit, rastet që i kemi dëgjuar sidomos rasti i fundit Toka ku asnjë gjyqtar vendor nuk e pranon rastin.

Atëherë cili do të jetë tani stimulimi dhe cili është raportimi para evropianëve që Kosova ka vullnet dhe ka guxim ta luftojë korrupsionin dhe krimin e organizuar, po them për pjesën që lidhet me njerëzit e politikës.

Këto që i përmendet ju gjatë raportimit ministre mund të jenë në një regjistër që kërkon matje konkrete.

Si ministri e integriteteve duhet ta keni një agjendë strikte të imponimit si ministri e Integriteteve, një presion pozitiv të bashkërendimit të aktiviteteve që me pasur të mundur me arritur rezultate, por me këtë formë nëse nuk ka një presion publik dhe luftim adekuat apo masa të shtuara do ta kemi shumë problem.

Pjesa tjetër duhet të jeni më të shpejtuar në përmbushjen e agjendës legislative dhe kur flasim për rastet që kanë të bëjnë me krimin dhe korrupsionin, këtu, në Kosovë, është parë se vetëm presioni publik pozitiv mundet me i ndihmuar kësaj shoqërie, ju e keni obligim t'i thoni me zë të lartë njerëzit e politikës që janë të lidhur me 39 rastet dhe me rastet të cilat janë mbyllur me vendim të formës së prerë, sepse kanë lënë shije të hidhur në sistemin e drejtësisë dhe luftimin e krimit dhe të korrupsionit.

Ministrja theksoi se sa i përket kushteve dhe kritereve shtesë ju i keni parë edhe deklarimet nga zyrtarët e lartë evropian që udhërrëfyeni për liberalizimin e vizave i ka 95

kritere, ndërsa pakoja e legjislacionit pa tjetër që është një nevojë që të ecim përpara me miratimin e kësaj pakoje sepse është në ERA, dhe këto janë domosdoshmëri që duhet të kalohen, por nuk janë kritere që janë në udhërrëfyesin e procesit të liberalizimit të vizave, pa tjetër që miratimi i këtyre projektligjeve do ta fuqizojë sektorin e sundimit të ligjit dhe do ta fuqizojë mekanizmin që ta luftojë krimin dhe korrupsionin, sepse është rast që disa ligje që kanë të bëjnë me ERA, të kalojnë në Kuvendë para publikimit të Raportit për vendin dhe kjo do të na mundësonte që t'i dërgojmë disa ndryshime të fundit që do të mundej ta ndryshonte pozitën e Kosovës.

Në ministrin tonë kemi takime shumë të shpeshta me mekanizmin e përcjelljes së kushtit të dytë dhe janë takime të rregullta dhe kemi vazhdimësi të rezultateve, por duke ditur kompetencat e ndara të gjyqësorit dhe prokurorisë ne mundemi vetëm të kërkojmë prej tyre ta përshpejtojnë punën dhe t'i trajtojnë këto 39 raste me prioritetin më të madh. Tek ministrinë e linjës kemi mbajtur komitetin teknik dhe aty i kemi informuar ministrinë se pakoja e ligjeve që ndërlihet sidomos me fuqizimin e sistemit të ligjit duhet sa më shpejtë të procedohen në Kuvend, por gjithnjë duke pas parasysh për të mos pësuar në kualitetin e ligjeve. Kurse sa i përket largimit të EULEX-it edhe aty Prokuroria është duke u marrë, por këtë pyetje mund t'ia bëni edhe ministrit të Drejtësisë.

Ilir Deda kërkoi nga ministrja që raporti vlerësues për sistemin e drejtësisë t'ju shpërndahet në mënyrë zyrtare të gjithë deputetëve të komisionit.

Është një pako e ligjeve që ndërlihet me ERA-në dhe liberalizimin e vizave, andaj për qartësi do duhej të kishim një listë që tregon se cila pako ligjore ka të bëjë me liberalizim e cila me sundim të ligjet, p.sh. përpos ligjeve që janë në Kuvend që ndërlihet me luftën kundër korrupsionit sa i përket liberalizimit të vizave, por janë edhe 4 ligje të tjera, që nuk kanë ardhur fare në Kuvend, nuk do të kishte me qenë në rregull që për shkak të mos aprovimit të pakos legjislative njerëzit tonë të mbesin të izoluar.

Në vazhdim kërkoi nga ministrja një përgjigje konkrete me numra, se cili është numri i saktë i ligjeve që duhet t'i kalojë Kuvendi i Kosovës që të përmbushet plotësisht kriteri për luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar sa i përket procesit të liberalizimit të vizave, sepse në Kosovë ekziston një keqkuptim stadeve të cilat i kërkon BE-ja lidhur me sistemin e drejtësisë. Pra duke i marrë afatet e ngushta kohore neve na duhen saktë të dimë se cilat ligje kanë mbetur si pjesë e pakos legjislative për liberalizim të vizave.

Pastaj duam të dimë se ku janë çalimet në ekzekutiv, sepse ne kemi marrë vendim javën e kaluar se ligjet parësore që i përkasin ERE-së t'i aprovojmë këtë javë, por Kodi penal, Kodi i procedurës penale, Ligji për kompetenca të zgjeruara, Ligji për konfiskim të pasurisë së pa ligjshme dhe Ligji për suspendimin e zyrtarëve të akuzuar dhe dënuar për korrupsion nuk na kanë ardhur në Kuvendin e Kosovës, duhet të ketë një koordinim më të madh mes Kuvendit dhe ekzekutivit.

Ministrja sqaroi se nuk ka pako të ligjeve për liberalizim të vizave, Udhërrëfyesi ka pasur 95 kritere dhe pakoja e ligjeve ka qenë ndër kriteret e para që është miratuar, këtu është një keqkuptim sepse pakoja e ligjeve është për procesin e ERA-së, mirëpo e fuqizojnë luftën tonë kundër krimin dhe korrupsionit, sepse nuk ka kushte të reja. Sa i përket pakos së ligjeve Kodi penal dhe Kodi i procedurës penale janë miratuar në vitin 2013 dhe është pa nevoja që duhet të plotësohen dhe ndryshohen sepse kemi pasur zbrazëtira të mëdha që kanë lënë vend për keqpërdorim.

Fatmire Kollçaku theksoi se tani më jemi para kushtit kryesor dhe me miratimin e demarkacionit kemi paguar çmim të lartë dhe BE-ja a është ajo që do t'i mbyllë sytë para realitetit në Kosovë, sepse të gjithë qytetarët në Kosovë janë të vetëdijshëm se që nga

pas lufta problemi më madhor është mungesa e luftimit të krimit të organizuar dhe korrupsionit, fakti që raportin që e lexoj kolegia, ministrja thotë se nuk i referohet direkt liberalizimit të vizave, a nënkupton kjo që realiteti është tjetër gjë? Tash e disa muaj po flasim për 7 dosje të përmbyllura dhe asnjë lëvizje prej numrit 39 atëherë ku jemi pra, asnjë provë nuk jeni duke e dhënë që seriozisht i qaseni luftimit të krimit dhe korrupsionit, po e shoh që luftohet në instanca më të ulëta, por nuk ka prova se luftohet në instanca më të larta dhe po shihet se gjyqtarët tanë nuk kanë pavarësi, sepse të akuzuarit lirohen apo mbrohen në liri edhe pse kanë prova të mëdha për krim dhe korrupsion.

Politika është e gatshme ta luftojë çdo kusht përveç krimit që duhet ta luftojë brenda vetvetes. Unë, si çdo qytetar tjetër i Republikës së Kosovës kam shumë dëshirë të ndodhë liberalizimi, mirëpo nuk ka prova se po luftohet në atë drejtim, përveç nëse BE-ja i mbyll sytë mund ta përmbyllim eventualisht si kriter, por faktikisht kjo nuk qëndron.

Ministrja tha se duhet ta kemi parasysh se Kosova, sa i përket kushtit të mbetur duhet të vlerësohet me vendet që kanë kaluar me liberalizimin e vizave, e jo me vendet që kanë një stad shumë më të avancuar në procesin e Integritimit Evropian, por edhe nëse krahasohemi me këto vende prapë kemi shumë progres në luftimin e krimit dhe korrupsionit dhe këtë e vërteton edhe Raporti i Transparency international që e ka përmirësuar pozitën e Kosovës për 10 vende dhe prapë po e theksojmë që ky kriter është që në vazhdimësi duhet të plotësohet edhe pas liberalizimit të vizave.

Ahmet Isufi thekso se pasi kemi të bëjmë me kushtin e fundit që duhet të përmbushet atëherë logjika e deri tashme e veprimit në Qeveri duhet të ndryshohet, duhet të rriten kapacitetet, duhet bërë një strategji më e përpunuar në mënyrë që komunikimi me të gjitha nivelet e BE-së të bëhet me i dendur, po ashtu angazhimi në përmbushjen e obligimeve që i kemi si shtet duhet të jetë prioritet, deri sa ne tani mundohemi ta përmbushim kriterin e liberalizimit të vizave të tjerët kanë mundësi të jenë kandidat apo anëtar të BE-së.

Shifrat nuk janë ato që e kanë domethënien e vet sa i përket liberalizimit të vizave, sepse më tepër matet efikasiteti i ndryshimit të gjendjes se sa shifrat që mund të afrohen.

Nëse drejtësia jonë edhe me tutje shkon nga viti 2012 kur e kemi veç udhërrëfyesin dhe nga ajo kohë kemi raste ende të pa zgjidhura do të thotë se jemi shumë larg përmbushjes, tani e tutje duhet krejt ndryshe të veprohet dhe të përmbushet edhe ky kriter i mbetur.

Ministrja pajtohet me parafolësin dhe tha se për këtë shkak e kemi ndryshuar edhe strategjinë dhe siç e kamë përmendur kemi takime javore dhe kemi kërkuar nga institucionet përgjegjëse që t'i trajtojnë me prioritet të gjitha rastet që ndërliken me luftimin e krimit dhe të korrupsionit, por këtu nuk mund të lëshohemi në detaje në lidhje me rastet sepse janë përgjegjësi vetëm e gjyqësorit dhe prokurorisë, por mund të shohim që ka progres, nuk janë, por mund të shohim që ka progres, nuk janë vendimet e prera të gjykatave që kërkohen, por është kontinuiteti, pa tjetër që do të ishte mirë që të kemi vendime të prera për 39 rastet, por duhet të gjejmë mekanizma që të gjejmë metoda për ta rritur llogaridhënien për prokurorinë gjyqësorin pa e cenuar pavarësinë e tyre.

Zenun Pajaziti tha fatkeqësisht edhe sivjet ne duhet të merrmi me temën e liberalizimit të vizave, tani ne duhet të punojmë me tepër me i shtuar kapacitetet dhe me qenë të kujdesshëm, nuk duhet të harrojmë që një numër i madh i kritereve janë përmbushur dhe duhet falënderuar të gjithë ata për angazhimin e tyre në përmbushjen e të gjitha atyre kritereve për liberalizim, por ne, si klasë politike jemi vonuar në përmbushjen e kriterit të

fundit sepse marrëveshja e demarkacionit na ka marrë 3 vjet dhe ne i kemi përgjegjësit tona si klasë politike. Te puna e drejtësisë që u tha me u fokusuar në mekanizma të llogaridhënies, mendoj se më mirë do te ishte mirë me bërë reforma në nxjerrjen e llogaridhënies dhe me punuar në atë drejtim që edhe ata me e pasur më të lehtë punën në përmbushjen sa me të shpejtë të kriterit të mbetur.

Në fund pyeti ministren se çka mundemi ne, si deputetë me u angazhuar përveç ligjeve, sepse nuk kanë qenë këto kritere vetëm teknike për liberalizimin e vizave, por në mënyrë të përsëritur kemi pasur ndërhyrje dhe kemi pasur thjesht vetëm kritere politike, prandaj nuk do të duhej të mungonte një angazhim me i madh në mënyrë që ky kriter të përmbillet sivjet dhe të mos përmbillen angazhimet në drejtësi vetëm me liberalizimin e vizave, por në vazhdimësi edhe pas liberalizimit.

Ministrja tha se Komisioni dhe partitë e përfaqësuara në Kuvend pa tjetër që mund të bëjnë shumë, sa më shpejt që procedohen ligjet kalojnë nëpër komisione dhe miratohen në Kuvend aq me tepër përkushtim tregojmë, në anën tjetër duhet ta vazhdojmë edhe më tej qasjen e koordinuar që e kemi pasur deri me tani të komunikimit tonë, si dhe me europarlamentarët gjatë vizitave në parlament dhe të gjithë të tjerët të kemi takime sa më të shtuara që ata të pajisen me informata dhe çfarëdo qoftë tjetër që ata mund të kërkojnë në procesin në vijim.

Milaim Zeka vlerësoi si plus të madh ndërkombëtar ministren, sepse nuk figuron në asnjë dosje të krimit gjithmonë e kam thënë dhe e them se çështja e drejtësisë është faj dhe përgjegjësi absolute e UNMIK-ut dhe EULEX-it, sepse ata e kanë pasur përgjegjësin për krimin në sistemin e drejtësisë për krimin në polici, prokurori dhe gjykatat, mbi bazën e kësaj fajet dhe meritat janë të përbashkëta edhe të vendorëve dhe ndërkombëtarëve, kështu që çështja e korrupsionit dhe krimit të organizuar është një sëmundje globale.

Ne fund pyeti ministren se a është e vërtetë që sipas disa ambasadorëve në takimin e mbajtur me zyrtarët e lartë të BE-së në Prishtinë, vetëm Kosova nuk ka sjellë asgjë me shkrim për strategjinë e ardhshme të Ballkanit Perëndimor për hyrjen në BE?

Ministrja tha se kemi dërguar shkresa me shkrim zyrtarëve të lartë atje për datat e samiteve që janë vijim ku do të marrin pjesë liderët e rajonit dhe aty do të sqarohet edhe implementimi i strategjisë për zgjerim.

Fitore Pacolli pyeti ministren se kisha dashtë të dijë se cila do të jetë përgjigja juaj para qytetarëve kur nuk do të ketë liberalizim të vizave sivjet dhe se keni gënjyer qytetarët se pas demarkacionit do të ketë liberalizim të shpejtë të vizave, sepse deri me sot isha e sigurt që 98% nuk do të ketë liberalizim të vizave sivjet, kurse tani jam qind për qind e sigurt se nuk do të ketë sivjet.

Ministrja tha se pyetja ime është çka do të bëni ju pas liberalizimit të vizave, sepse ai raport që ju prezantuat nuk lidhet me punën e liberalizimit të vizave dhe nëse liberalizohen vizat sivjet do te takohemi prapë dhe do ta bëj këtë pyetje.

Armend Zemaj tha se ju si ministre keni kontakte të drejtpërdrejta me zyrtarët e lartë të BE-së dhe ndoshta do te ishte mirë neve me na kanalizuar në drejtimin e lobimit si deputet pas ratifikimit të demarkacionit.

Ministrja ju e keni lexuar edhe deklaratat publike qoftë të znj. Fajon dhe zyrtarëve të tjerë të lartë të BE-së dhe deklarata e përbashkët e përgëzon plotësimin e kushtit kyç dhe tani Kosova është afër procesit të liberalizimit të vizave dhe prapë po theksoj duke u bazuar në vendet që kanë kaluar procedurat që tani gëzojnë lëvizjen e lirë për afërsisht presim që nga fundi i vitit 2018 të lëvizim pa viza.

Kryetarja falënderoi ministren dhe tha se presim që të takohemi dhe të dakordohemi për agjenda tona të përbashkëta, në mënyrë që ta përshpejtojmë në masë të madhe këtë proces.

Pasi që ministri i drejtësisë kishte lajmëruar se do të vonohet, kryetarja vazhdoi me pikat e tjera të rendit të ditës.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-031 për Pajisjet nën Presion, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja paraqiti opinionin ligjor lidhur me këtë Projektligj duke theksuar se nuk është në kundërshtim me Legjislacionin e BE-së dhe i rekomandohet Kuvendit për miratim, hapi debatin dhe pastaj hodhi në votim projektligjin me amendamente.

Pas votimit kryetarja konstaton se komisioni një zëri nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr. 06/L-031 për Pajisjet nën Presion, me amendamentet e Komisionit Funkcional nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe si i tillë i rekomandohet Kuvendit për miratim

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja paraqiti opinionin ligjor lidhur me këtë Projektligj duke theksuar se nuk është në kundërshtim me Legjislacionin e BE-së dhe i rekomandohet Kuvendit për miratim, hapi debatin dhe pastaj e hodhi në votim Projektligjin me amendamente.

Pas votimit **Kryetarja** konstaton se Komisioni një zëri nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, me amendamentet e Komisionit Funkcional nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe si i tillë i rekomandohet Kuvendit për miratim.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-036 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për të Huajt, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së

Kryetarja paraqiti opinionin ligjor lidhur me këtë Projektligj duke theksuar se nuk është në kundërshtim me Legjislacionin e BE-së dhe i rekomandohet Kuvendit për miratim hapi debatin dhe pastaj hodhi në votim Projektligjin me amendamente.

Pas votimit **Kryetarja** konstaton se komisioni një zëri nxori këtë:

Rekomandim

Projektligjit nr. 06/L-036 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për të Huajt, me amendamentet e Komisionit Funkcional nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe si i tillë i rekomandohet Kuvendit për miratim.

7. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 06/L-026 për Azil, me amendamentet e Komisionit Funkcional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.

Kryetarja paraqiti opinionin ligjor lidhur me këtë Projektligj duke theksuar se nuk është në kundërshtim me Legjislacionin e BE-së dhe i rekomandohet Kuvendit për miratim, pastaj hapi debatin dhe hodhi në votim Projektligjin me amendamente.

Pas votimit **kryetarja** konstaton se Komisioni një zëri nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji nr. 06/L-026 për Azil, me amendamentet e Komisionit nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe si i tillë i rekomandohet Kuvendit për miratim.

8. Të ndryshme.

Në të ndryshme, Komisioni ka shqyrtuar dhe tre projektligje tjera jashtë rendit të ditës së paraparë në këtë mbledhje, si në vijim:

a. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 06/L-041 për kërkesat teknike për produktet dhe vlerësim të konformitetit, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.

Kryetarja paraqiti opinionin ligjor lidhur me këtë Projektligj duke theksuar se nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe i rekomandohet Kuvendit për miratim, hapi debatin dhe pastaj hodhi në votim Projektligjin me amendamente.

Pas votimit **kryetarja** konstaton se komisioni një zëri nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji Nr. 06/L-041 për kërkesat teknike për produktet dhe vlerësim të konformitetit, me amendamentet e Komisionit funksional nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe si i tillë i rekomandohet Kuvendit për miratim.

- b. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 06/L-037 për metrologji, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.**

Kryetarja paraqiti opinionin ligjor lidhur me këtë Projektligj duke theksuar se nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe i rekomandohet Kuvendit për miratim, hapi debatin dhe pastaj hodhi në votim Projektligjin me amendamente.

Pas votimit **Kryetarja** konstaton se komisioni një zëri nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji Nr. 06/L-037 për metrologji, me amendamentet e Komisionit funksional nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe si i tillë i rekomandohet Kuvendit për miratim.

- c. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 06/L-029 për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore, me amendamentet e Komisionit funksional nga aspekti i përputhshmërisë me legjislacionin e BE-së.**

Kryetarja paraqiti opinionin ligjor lidhur me këtë Projektligj duke theksuar se nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe i rekomandohet Kuvendit për miratim, hapi debatin dhe pastaj hodhi në votim Projektligjin me amendamente.

Pas votimit **Kryetarja** konstaton se komisioni një zëri nxori këtë:

Rekomandim

Projektligji Nr. 06/L-029 për mbrojtje nga rrezatimi dhe siguria bërthamore, me amendamentet e Komisionit funksional nuk është në kundërshtim me legjislacionin e BE-së dhe si i tillë i rekomandohet Kuvendit për miratim.

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e komisionit

Kryetare e komisionit,

Blerta Deliu Kodra